



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-03 dt. 21.06.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 14-350/05-0069714/18 dt. 22.03.2018 për Caktimin e Mënyrës Së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane, si dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-147459/20 dt. 20.08.2020, të pronarëve npt "Agro-Trade" shpk dhe Shehize Alidema, me investitor ntp "Agro-Trade Group" shpk me seli në Prishtinë dhe me nr. unik identifikues të biznesit 810502535 dhe me pronar Sadudin Humolli nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste, në lagjen "Mati 1", në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 14.09.2020, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarëve npt "Agro-Trade" shpk dhe Shehize Alidema, me investitor ntp "Agro-Trade Group" shpk me seli në Prishtinë dhe me nr. unik identifikues të biznesit 810502535 dhe me pronar Sadudin Humolli nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-147459/20 dt. 20.08.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste- ndërtesa "ATG 1", "ATG 2" dhe "ATG 3", në kuadër të Bllokut Urban "A16" dhe "A17", të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 668-0, 669-1 dhe 669-2 ZK Matičan.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Mat 1" të miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal nr. 01. nr. 35 - 18186 të dt. 03.08.2005, Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Mati 1" në Prishtinë, i miratuar me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati I" të Kuvendit të Komunës së Prishtinës me 01. nr. 35 – 642, të dt. 01.04.2010, si dhe Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati I" të Kuvendit të Komunës së Prishtinës me 01. nr. 031 -1678 të dt. 20.07.2011, ku sipas këtij plani ky lokacion përfshihet në ngastrën e ndërtimit "F", tipi MI. Si dhe Planin Zhvillimor Urban i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës 01 nr. 031-181427 dt.24.09.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë ka destinim "Ndërtim i lartë".

Pronarët dhe investitori për kriteret dhe parametrat urban si dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes "Informim nga Plani Rregullues "Mat 1"- PZHU" 05-350-290524 dt. 01.12.2016 , lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit- parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - 668-0 ZK. Matičan, me $S=3'037m^2$, me pronar npt Agro-Trade shpk, arë e klasës 5;
 - 669-1 ZK. Matičan, me $S=3'541m^2$, me pronar npt Agro-Trade shpk, arë e klasës 4;
 - 669-2 ZK. Matičan, me $S=880m^2$, qeramarrje për 99 vite Shehize Alidema, kullosë e klasës 4;

- Të drejtat pronësore-juridike për parcelat kadastrale 668-0 dhe 669-1 ZK. Prishtinë janë private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale, si dhe parcela kadastrale 669-2 ZK. Prishtinë është në qera mbajtje për 99 vite;
- Në kuadër të këtyre parcelave, nuk ka ndërtesa ekzistuese;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrësi të vogël nga lindja në drejtim të perëndimit;
- Qasja ekzistuese në parcelë kadastrale është përmes rrugës ekzistuese "Shaqir Igrishta";
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore dhe ndërtesa të banimit në bashkëpronësi.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin- ndërtimin e ndërtesës së banimit, në kuadër të Planit Rregullues Prishtina e Re- Zona Qendër në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i lokacionit – "Situacioni", bashkëngjitur këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Pjesa e parcela kadastrale e trajtuara për realizimin e ndërtesave, konkretisht pjesa e parcelës kadastrale e përfshirë- e trajtuar brenda vijës rregulluese, është:

Blloku Urban "A16":

- 668-0, me $S=522m^2$;
- 669-1, me $S=1491m^2$;
- 669-2, me $S=104m^2$;

Sipërfaqe totale $S=2117m^2$.

Blloku Urban "A17":

- 668-0, me $S=1695m^2$;
- 669-1, me $S=1461m^2$;
- 669-2, me $S=105m^2$;

Sipërfaqe totale $S=3261m^2$.

- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesës, konkretisht të përfshira- trajtuara jashtë vijës rregulluese, janë:

Blloku Urban "A16":

- 669-1, me $S=44m^2$;
- 669-2, me $S=379m^2$;

Sipërfaqe totale $S=423m^2$

Blloku Urban "A17":

- 669-1, me $S=361m^2$;
- 669-2, me $S=292m^2$;

Sipërfaqe totale $S=653m^2$

- Sipërfaqja prej $203m^2$ e parcelës kadastrale nr. 668-0 ZK. Matiçan, shtrihet në bllok tjetër të Planit Rregullues "Mati 1" dhe mbetet të trajtohet me bllokun tjetër në fazë tjetër, si dhe pjesa prej $617m^2$ e parcelës kadastrale nr. 668-0 ZK. Matiçan dhe pjesa prej $184m^2$ e parcelës kadastrale nr. 669-1 ZK. Matiçan të cilat shtrihen në rrugë të planifikuar sipas Planit Rregullues "Mati 1", nuk janë trajtuar me këto Kushte Ndërtimore.
- Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelave kadastrale të përfshira në bllokun urban "A16" dhe "A17" të Planit Rregullues "Mati 1", planifikohet të realizohet/ndërtohet kompleksi me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, me sipërfaqe bruto ndërtimore **$S=24'286.75m^2$** /

17'515.50m² mbitokë + 6'771.25m² nëntokë (sipas projekt propozimit të prezantuar), të shpërndara në ndërtesa si vijon:

- "Ndërtesa ATG 1" në bllokun "A16" – 2B+S+P+11, 11'093.75m² / 8'128.50m² mbi tokë + 2'965.25m² nën tokë;
- "Ndërtesa ATG 2" në bllokun "A17" – 2B+P+8, 8'527.70m² / 6'239.60m² mbi tokë + 2'288.10m² nën tokë;
- "Ndërtesa ATG 3" në bllokun "A17" – 2B+P+6, 4'665.30m² / 3'147.40m² mbi tokë + 1'517.90m² nën tokë;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë për banim shumëbanesor dhe afarizëm, me hapësira përcjellëse si: kthina teknike, depo, hapësira garazhuese, etj. (sipas projekt propozimit të prezantuar);
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesave në bazë- gabarit të përdhësës ose suterrenit, në bazë të PZhU, është 0.2 deri 0.4:

Blloku Urban "A16":

$$S = 2117 \times 0.4 = 846.80\text{m}^2$$

$$\text{Sipas projekt propozimit} = 846.00\text{m}^2$$

Blloku Urban "A17":

$$S = 3261 \times 0.4 = 1'304.40\text{m}^2$$

$$\text{Sipas projekt propozimit} = 1270\text{m}^2$$

$$\text{Total} = 2'151.20\text{m}^2$$

$$\text{Sipas projekt propozimit} = 2116.00\text{m}^2$$

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHN), për vendosjen e ndërtesave në bazë- gabarit të bodrumit, lejohet max. 60% (0.6):

Blloku Urban "A16":

$$S = 2117 \times 0.6 = 1'270.20\text{m}^2$$

$$\text{Sipa projekt propozimit} = 1'268.40\text{m}^2$$

Blloku Urban "A17":

$$S = 3261 \times 0.6 = 1'956.60\text{m}^2$$

$$\text{Sipas projekt propozimit} = 1'949.75\text{m}^2$$

$$\text{Total} = 3'226.80\text{m}^2$$

$$\text{Sipas projekt propozimit} = 3'218.15\text{m}^2$$

- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe sipërfaqet gjelbëruese, ku koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, është min. 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%.

Blloku Urban "A16":

$$S = 2117 \times 0.4 = 846.80\text{m}^2 \text{ ose } S = 2117 \times 0.3 = 635.10\text{m}^2 \text{ (nëse ndërtohet kulmi i gjelbër)}$$

Blloku Urban "A17":

$$S = 3261 \times 0.4 = 1'304.40\text{m}^2 \text{ ose } S = 3261 \times 0.3 = 978.30\text{m}^2 \text{ (nëse ndërtohet kulmi i gjelbër)}$$

$$\text{Total} = 2151.20\text{m}^2 \text{ ose } 1'613.40\text{m}^2 \text{ (nëse ndërtohet kulmi i gjelbër)}$$

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN), sipas PRrU, për bllokun "A16" është 3.2, ndërsa për bllokun "A17" është 2.4, kurse sipas PZhU për të dy blloqet pjesërisht 1.8-3.0 dhe pjesërisht 1.2-1.8, mirëpo, me implementimin e Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 14-350/05-0069714/18 dt. 22.03.2018 për Caktimin e Mënyrës Së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane, meqenëse blloqet janë të realizuara në masën mbi 50% të sipërfaqeve të tyre, përvetësojmë koeficientët e PRrU. Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese- parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë- suteran, dhe **0%** për etazhet e nëntokës- bodrume, dhe ka sipërfaqe si në vijim:

Blloku Urban "A16":

$$S = 2117 \times 3.2 = 6'774.40m^2$$

Blloku Urban "A17":

$$S = 3261 \times 2.4 = 7'826.40m^2$$

Total = 14'600.80m²

- Vendimin 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik aplikohet për sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20%. Bazuar në sipërfaqen e pjesëve të parcelave kadastrale të përfshira jashtë vijës rregulluese prej $S=369m^2$, si dhe raporti i sipërfaqeve jashtë / brenda vijave rregulluese është:

Blloku Urban "A16":

$S=423 / 2117 \times 100 = 19.9\%$, andaj sipas këtij Vendimi, mund të kompensohet/shpronësohet sipërfaqja prej $S=424m^2$, dhe kalkulohet me koeficient ndërtimi 3.2. Pra, sipërfaqja e kompensuar do të jetë:

$$423 \times 3.2 = 1'353.60m^2$$

Blloku Urban "A17":

$S=653 / 3261 \times 100 = 20.0\%$, andaj sipas këtij Vendimi, mund të kompensohet/shpronësohet sipërfaqja prej $S=653m^2$, dhe kalkulohet me koeficient ndërtimi 2.4. Pra, sipërfaqja e kompensuar do të jetë:

$$653 \times 2.4 = 1'567.2m^2$$

Sipërfaqe totale për komepsim: $1'353.60$ (A16) + $1'567.20$ (A17) = $2'920.80m^2$

Sipërfaqe totale për ndërtim:

$$\text{Blloku "A16"} = 6'774.40 + 1'353.60 = 8'128m^2$$

$$\text{Blloku A'17"} = 7'826.40 + 1'567.2 = 9'393.60m^2$$

- Bazuar në kriteret e planit rregullues, për bllokun "A16", tipi i mbulimit d1, mundëson ndërtimin e ndërtesave me një gjatësi prej maksimum $50m'$ dhe sipërfaqe të lirë $0.4H$ (ku H është lartësia e ndërtesës) ose së paku $3m'$, me thellësi të ndërtesës në frontin rrugor max. $20m$. Ndërsa për bllokun "A17" tipi i mbulimit d5, mundëson ndërtimin e ndërtesave me një gjatësi prej maksimum $25m'$ dhe sipërfaqe të lirë prej $0.4H$ (ku H është lartësia e ndërtesës) ose së paku $3m'$.
- Qasja në parcelë, gjegjësisht në blloqe të jetë përmes rrugës së planifikuar të planit rregullues, të paraqitur në Planin "Situacioni". Kycja të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo;
- Kuota e përdhësës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e nivelit të rrugës publike, nga e cila ka qasje parcela, gjegjësisht në krahasim me kuotën zero, por jo më e ulët se kuota e nivelit të rrugës publike dhe ajo është max. $1.2m$;

- Parkimi i makinave për nevojat e banorëve (shfrytëzueseve) të ndërtesave të banimit të sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të blloqeve. Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi standardi i parkimit respektivisht i garazhimit sipas Planit Rregullues "Mat 1" dhe Rregullores MMPH nr. 03/2016 është 1VP/njësi banimore. Për pjesën e afarizmit min. 1VP për 30m² afarizëm sipërfaqe të shfrytëzueshme. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritit të ndërtesës;
- Kompleksi të organizohet edhe me vendparkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotualet, terrenet sportive, këndet e lodrave për fëmijë, etj.
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për grumbullimi e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i saj, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efikasitetit të energjisë, dhe t'i përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar, si dhe karakterit dhe kontekstit të zonës;
- Bazuar në nenin III të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Aplikimi i të gjithave kushteve dhe kriteret tjera urbane & arkitektonike të përcaktuar në kriteret & parametrat urban të Planit Rregullues "Mati 1" dhe Planit Zhvillimor Urban- PZHU.

V. Ndarja / Parcelimi i parcelave kadastrale nr. 668-0, 669-1 dhe 669-2 ZK. Matičan, si dhe **bashkimi i parcelave**, gjegjësisht krijimi i dy parcelave ndërtimore për çdo bllok urban, do të bëhet sipas parcelave ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese, bazuar në Planin Rregullues "Mati 1", Planin i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen dhe bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes dhe bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes dhe bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Planin i situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i sipërfaqes së mbetur të pjesëve të parcelave kadastrale nr. 669-1 dhe 669-2 ZK. Matičan, veçanërisht për çdo bllok urban, gjegjësisht $S=423m^2$ për bllokun "A16" dhe $S=653m^2$ për bllokun "A17", do të bëhet sipas Vendimit 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik, e cila aplikohet për sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20%. Sipas kalkulimeve në paragrafin IV të këtij Vendimi, parcela ndërtimore e bllokut "A16" është me sipërfaqe prej 2117m², ndërsa parcela ndërtimore e bllokut "A17" është me sipërfaqe prej 3261m². Bazuar në Vendimin 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, dhe raportit të sipërfaqeve të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqes jashtë vijës rregulluese (sipërfaqja e pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik) përcaktuar në përqindje (%) është:

Blloku "A16":

$S=423 / 2117 \times 100 = 19.9\%$. Andaj sipas Vendimit të lartcekur, mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore sipërfaqja prej $S= 423m^2$. Sipas kalkulimit, sipërfaqja e kompensuar do të jetë $S=423 \times 3.2 = 1'353.60m^2$.

Blloku "A17":

$S=653 / 3261 \times 100 = 20.0\%$. Andaj sipas Vendimit të lartcekur, mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore sipërfaqja prej $S= 653m^2$. Sipas kalkulimit, sipërfaqja e kompensuar do të jetë **$S=653 \times 2.4 = 1'567.20m^2$** .

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore për pjesën e parcelave kadastrale nr. 669-1 dhe 669-2 ZK. Matëçan, bazuar në Vendimet e lartcekura. Kjo procedurë e kompensimit me sipërfaqe ndërtimore, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelave dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës.

Sipërfaqet definitive të shpronësimit / kompensimit me sipërfaqe ndërtimore të trajtohet pas ndarjes dhe barazimit të sipërfaqeve të parcelave kadastrale sipas këtij paragrafi të këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronari & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

Procedura e kompensimit/shpronësimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore.

VII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo Drejtoria. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin- adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"- Ngrohitorja e Qytetit sh.a dhe PTK.

VIII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, "Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit ne bashkëpronësi ", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje fizike dhe një (1) digjitale, në këtë përmbajtje:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdheshë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;
- Elaboratin për ndërtimin e kulmit të gjelbër.

IX. Dokumentacioni ndërtimor për Masat Mbrojtëse nga Zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtim të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m², me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdheshë, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

X. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

XI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe

Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo Drejtoria, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore- këtë Vendim, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo Drejtoria (kopje);
- Autorizimin për përfaqësim;
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve.

XII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës, në tokë ndërtimore- meqenëse pjesët e parcelat kadastrale të përfshira në këto kushte ndërtimore, në bazë të certifikatave të njësive kadastrale, janë evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelave si në vijim: 668-0 “Arë e Klasës 5”, 669-1 “Arë e Klasës 4”, si dhe 669-2 “Kullës e Klasës 4”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen e parcelave ndërtimore, gjegjësisht 2117m² për bllokun “A16” dhe 3261m² për bllokun “A17”, total S=5378m², sipas Plani i situacionit – “zgjidhja urbane”. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, andaj, kjo Drejtoria jep PËLQIM për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Kjo pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, para aplikimit për leje ndërtimore, bazuar në pëlqimin e dhënë në këtë paragraf.

XIII. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për Dhënien e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifën për Rregullimin e Infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XIV. Vlefshmëria e Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronarët npt “Agro-Trade” shpk dhe Shehize Alidema, me investitor ntp “Agro-Trade Group” shpk me seli në Prishtinë dhe me nr. unik identifikues të biznesit 810502535 dhe me pronar Sadudin Humolli nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02-147459/20 dt. 20.08.2020, kanë kërkuar nga kjo drejtoria caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste- ndërtesa “ATG 1” – 2B+S+P+11,

“ATG 2” – 2B+P+8 dhe “ATG 3” – 2B+P+6, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I të dispozitivit të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar këtë dokumentacion: dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale 668-0, 669-1 dhe 669-2 ZK. Matiçan; Vërtetim mbi obligimet tatimore të Shehide Alidema me nr. 130804/20 dt. 30.07.2020, Agro Trade Group me nr. 136948/20 dt. 10.08.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës; kopje të dokumentit identifikues të Skender Alidema, Shehide Alidema dhe Sadudin Humolli; Certifikatën e regjistrimit të biznesit “Agro-Trade Group” shpk me nr. unik identifikues 810502535; “Informim nga Plan i Rregullues Mati 1 – PZhU” nr. 05-350-290524 dt. 01.12.2016; Foto të lokacionit; “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” lrp nr. 4816/2020 dt. 12.06.2020, e lidhur në mes Shehide Alidema nga Prishtina, në cilësinë e pronares së tokës, si dhe investitorit “Agro-Trade Group” shpk me nr. unik 810502535; Inçizimin gjeodezik për parcelat kadastrale, të punuar nga gjeodeti Agon Blakaj me nr. licence 205; Propozimin për ndarje të parcelave kadastrale, si dhe bashkim të parcelave në një parcelë të vetme, të punuar nga gjeodeti Enis Hoda me nr. licence 172; Projekti ideor.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në nenin 13 pika 1.2 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, ka vendosur njoftimin publik në lokacion me datë 26.08.2020. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore në fuqi, ka qëndruar pesëmbëdhjetë (15) ditë në lokacionin në fjalë, gjegjësisht deri më datë 09.09.2020.

Me dt. 08.09.2020, Drejtoria e Urbanizmit, përmes shkresës 05-070/01-161080/20, ka pranuar ankesën e Lulzim Latifi nga Prishtina, kundër njoftimit publik nr. 05-350/02-147459/20 të dt. 26.08.2020 deri me 09.09.2020 të kërkesës 05-350/02-147459/20 dt. 20.08.2020 për caktimin e kushteve ndërtimore, me të cilën njoftohet Drejtoria e Urbanizmit se ankuesi ka kontest gjyqësor me kërkuessin, në lidhje me parcelën kadastrale për të cilën janë kërkuar kushtet ndërtimore.

Ky organ, përmes procesverbalit 05-350/02-147459/20 dt. 10.09.2020, nga kërkuessi i kushteve ndërtimore, si plotësim dokumentacioni, ka pranuar dokumentacionin si në vijim: “Aktgjykim” C. nr. 1247/16 dt. 18.06.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas të cilës refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë bashkëpronarë në parcelën kadastrale 668-0 dhe 669-1; “Aktgjykim” Ac. nr. 4949/19 dt. 10.04.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, sipas të cilës refuzohet ankesa e paditësve, ndërsa vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 1247/16 dt. 18.06.2019; “Aktvendim” C. nr. 1247/16 dt. 29.06.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas të cilës shfuqizohet masa e sigurimit të kërkesëpadisë e caktuar me Aktvendimin e gjykatës së Apelit Ac. nr. 4216/17 dt. 20.10.2017.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të ankesës 05-070-01-161080/20 dt. 08.09.2020 dhe përmbajtjes së saj, si dhe bazuar në dokumentacionin e prezantuar me procesverbalin 05-350/02-147459/20 dt. 10.09.2020 dhe shqyrtimit të saj, si dhe pas vërtetimit në regjistrin kadastral, përmes shkresës “Informim” 05 nr. 070/01/161080/20 dt. 10.09.2020 e ka informuar ankuesin se, parcelat kadastrale për të cilat me kërkesën 05-350/02-147459/20 dt. 20.08.2020 janë kërkuar kushtet ndërtimore, gjegjësisht 668-0, 669-1 dhe 669-2 ZK. Matiçan, nuk kanë masë të përkohshme, andaj, nuk kemi bazë për ndërprerjen e procedurës për caktimin e kushteve ndërtimore.

Pas përfundimit të procedurës, gjegjësisht përgjigjes në ankesën e sipërpërmendur, është vazhduar me procedurën e caktimit të kushteve ndërtimore.

Parcelat kadastrale për të cilat caktohen kushtet ndërtimore me këtë Vendim, shtrihen në kuadër të Planit Rregullues “Mati 1” dhe Planit Zhvillimor Urban- PZhU. Bazuar në PRrU, koeficienti ndërtimor për bllokun “A16” është 3.2 dhe për bllokun “A17” është 2.4, ndërsa bazuar në PZhU, për të dyja

blloqet destinimi pjesërisht është ndërtim i lartë me koeficient nga 1.8 deri në 3.0, si dhe pjesërisht është ndërtim i mesëm i përzier me koeficient nga 1.2 deri në 1.8. Duke u bazuar se të dyja blloqet janë të realizuara në masën mbi 50% e sipërfaqeve të tyre, me implementimin Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 14-350/05-0069714/18 dt. 22.03.2018 për Caktimin e Mënyrës Së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane, gjegjësisht pika 1 e nenit 5, përvetësojmë koeficientët e PRrU, gjegjësisht 3.2 për bllokun "A16" dhe 2.4 për bllokun "A17".

Sipas mendimit profesional nga faza e komunikacionit, të dt. 01.09.2020, kyçja për automjete në rrugë të planifikuar, për ndërtesën ATG 1 – 2B+S+P+11, ATG 2 – 2B+P+8 dhe ATG 3 – 2B+P+6, mund të pranohet si e tillë, marr parasysh kategorinë e rrugës së planifikuar dhe shmangien e kyçjes në raport me udhëkryqet e rrugëve të planifikuara. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullore për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimi në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuar sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo.

Pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02-147459/20 dt. 20.08.2020, Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 "për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimimi për Kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuksi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe se projekti ideor i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të Planit Rregullues "Mati 1" dhe Planit Zhvillimor Urban- PZhU për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i lokacionit - "Situacioni"; "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ Kosovaref01" të punuar nga kjo Drejtori; si dhe "Propozim për ndarje dhe bashkim të parcelave kadastrale" të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MEA.

Ky Vendim u shtyp në 4 (katër) kopje identike fizike dhe i dërgohet: Kërkuesit/ve; kësaj Drejtorie; Qendrës për Shërbim me Qytetarë; dhe në dosje të lëndës.

Kopje elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm; dhe Drejtorisë së Kadastrit.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 350/02-147459/20 DT. 14.09.2020

Zyrtari:

Arbër Hamidi


u.d. Udhëheqëse e Sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi

Faqe 10 prej 10



	Përdhesa (SHPUTA)	Gjelbërimi (30%) (Kulmi i Gjellbërt)	Sip. mbi Tokë	Sip. nën Tokë	Sip. totale
Ndërtesa ATG 1 BLOKU A16	844.00 m ²	646.80 m ² + (Kulmi i Gjellbërt)	8128.50 m ²	2965.25 m ²	11093.85 m ²
Ndërtesa ATG 2 BLOKU A17	763.0 m ²	985.65 m ² + (Kulmi i Gjellbërt)	6239.60 m ²	2288.10 m ²	8527.70 m ²
Ndërtesa ATG 3 BLOKU A17	504.50 m ²	985.65 m ² + (Kulmi i Gjellbërt)	3147.40 m ²	1517.90 m ²	4665.30 m ²



archIN architecture design consulting

agrotrade anyplace, anywhere

AGRO TRADE GROUP, Sh.P.K.

Projektant: i.d.a. ISA NASUFI

Investitori:

Lokacioni:	TËRSIA A - MATI 1 - BLOKU A16 dhe A17 P-668-0, 669-1, 669-2 - Z.K. MATIÇAN		
Emërtimi i objektit:	KOMPLEKSI AGRO TRADE 2B+S+P+11, 2B+P+8 dhe 2B+P+6		
Emërtimi i vizatimit:	SITUACIONI I GJËRË		
Faza e projektit:	PROJEKTI KONCEPTUAL	ARKITEKTURA	
Përpjesa:	1:500	Data:	GUSHT 2020
Faqe:	C-05		




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku, gjeod.

Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 11.09.2020

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- - - Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY 668-0

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 669-1 dhe 669-2


Zona kadastrale / Katastarska zona: Matiçan

Numri i lëndës / Broj predmeta: /

Lloji i njësive kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Projektpropozim ndarje te parcelave Shkalla e zvoglimit / Razmera plana: 1: 500

Projektpropozimi per ndarjen është bërë nga ana
e arkitektit: Isa Nasufi

Nr.	Y	X
1	7514617.610	4723830.930
2	7514611.423	4723835.280
3	7514610.200	4723836.140
4	7514605.130	4723839.700
5	7514604.114	4723840.422
6	7514590.725	4723853.140
7	7514560.464	4723855.880
8	7514554.512	4723856.420
9	7514562.543	4723861.300
10	7514565.645	4723862.893
11	7514569.863	4723865.060
12	7514569.363	4723867.927
13	7514567.810	4723876.839
14	7514567.524	4723878.479
15	7514571.388	4723891.086
16	7514587.109	4723908.189
17	7514591.010	4723912.433
18	7514595.077	4723924.429
19	7514606.260	4723930.732
20	7514606.772	4723932.895
21	7514608.090	4723938.457
22	7514612.207	4723943.548
23	7514624.435	4723958.680
24	7514641.703	4723953.724
25	7514657.734	4723949.278
26	7514665.547	4723934.900
27	7514669.061	4723928.432
28	7514659.651	4723904.154
29	7514641.113	4723869.433
30	7514639.612	4723866.622
31	7514639.473	4723866.224
32	7514636.804	4723858.606
33	7514631.835	4723851.275
34	7514629.988	4723848.565
35	7514629.286	4723856.425
36	7514624.755	4723854.961
37	7514620.992	4723863.086
38	7514622.832	4723869.422
39	7514618.953	4723877.257
40	7514625.983	4723883.263
41	7514628.083	4723889.014
42	7514647.407	4723941.946
43	7514617.945	4723938.883
44	7514606.777	4723932.227
45	7514609.918	4723925.573
46	7514611.727	4723921.741
47	7514623.839	4723897.506
48	7514611.886	4723891.532
49	7514601.820	4723911.867
50	7514600.899	4723910.621
51	7514594.337	4723901.737
52	7514573.250	4723873.189
53	7514576.862	4723870.766



Legjenda:

- Parcela kadastrale
- Parcelat e projektuara

Rilevoi / Snimio: MSc. Enis Hoda, gjeod. i lic.

(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime gjeodeta/ kompanija)

Nr. i licencës / Br. licence: 172

Nënshkrimi / Potpis: [Signature]

Data e rilevimit / Datum snimanja: 11.09.2020

Aprovui / Usvojio: [Signature]

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: [Signature]

Data e aprovimit / Datum usvajanja: [Signature]

